



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 1894 Prot.
7

Pogradec, më 30 . 05 .2025

VENDIM

NR. 50 , DATË 29 . 05 .2025

**PËR
KRIJIMIN E KËSHILLIT ARTISTIKO – KULTUROR DHE SHPËRBLIMIN
E ANËTARËVE TË TIJ.**

Në mbështetje të; nenit 113 të Ligjit Nr. 8417, datë 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; shkronjës "d" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligjit Nr.8480, datë 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar; Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; Ligjit Nr.10 352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe kulturën", i ndryshuar; Ligji Nr. 79/2017 "Për sportin"; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.540, datë 21.12.1992, "Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre", i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.121, datë 25.2.2005, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr.540, datë 21.12.1992 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre", si dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr. 109, datë 02.12.2021, "Për themelimin e shoqërisë "Qendra Multifunkionale Pogradec sh.a" dhe miratimin e aktit të themelimit", Vendimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr.110, datë 02.12.2021, "Për miratimin e statutit të shoqërisë "Qendra Multifunkionale Pogradec sh.a", të konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën Nr. 1196/1 prot, datë 14.12.2021, me propozim të shoqërisë Qendra Multifunkionale Pogradec Sh.a dhe Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë krijimin e Këshillit Artistiko – Kulturor pranë Bashkisë Pogradec, i cili do të shërbejë si organ vendimarrës, këshillues dhe vlerësues të Qendra Multifunkionale Pogradec Sh.a, me përbërje si më poshtë:

1.1 Kudret DUROLLARI
1.2 Edmond GUSHO
1.3 Ilir SHYTA

KRYETAR
ANËTAR
ANËTAR

PIKTOR
KOMPOZITOR
PEDAGOG LETRAR



Handwritten signature

2. Miratimin e pagesës për çdo anëtar të Këshillit Artistiko – Kulturor, në vlerën 4 500 (Katër mijë e pesëqind) lekë, për çdo mbledhje, por jo më shumë se 6 (Gjashtë) mbledhje në një vit kalendarik.
3. Këshilli Artistiko – Kulturor, do të jetë me mandat dy vjeçar dhe afati llogaritës fillon nga data e marrjes vendim të Këshillit të Bashkisë Pogradec.
4. Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Artistiko – Kulturor do të përballohet nga shpenzimet operative të Shoqërisë Qendra Multifunkionale Pogradec Sh.a.
5. Efektet: Në përmbushje të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.540, datë 21.12.1992, “Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre”, i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.121, datë 25.2.2005, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr.540, datë 21.12.1992 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre”, me qëllim:
 - Promovimi i artit, kulturës dhe sportit në nivel lokal.
 - Kordinimi i aktiviteteve gjatë gjithë vitit, duke përfshirë festivale, ekspozita, ngjarje sportive etj.
 - Konsultimi dhe sugjerimi për politikat e zhvillimit kulturor në Bashkinë Pogradec.
 - Identifikimi dhe mbështetja e personaliteteve dhe grupeve artistike dhe sportive.
 - Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe artistike të qytetit.
6. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Turizmit pranë Bashkisë Pogradec dhe Administrata e Shoqërisë, Qendra Multifunkionale Pogradec Sh.a.
7. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.
8. U shpall sot më datë 29.05.2025.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

1.Miratuar me 24 vota

2.Vota Pro 24

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 30.05.2025

